

Qyteti im

SPECIALE

falas

Së bashku
gjate 2008
arritëm

*Jetoj në një qytet që E DUA
Brenda zemrës së tij kristal
Dhe ndruhem, a do të mundem dot
Që nga vetja ime diçka t'i fal*

Skënder Rusi



**KORÇA KU
DUA TE JETOJ**

Pas një viti të suksesshëm me një numër lexuesish gjithnjë në rritje, QYTETI IM vjen me:

- ➔ më tepër informacion
- ➔ më tepër rubrika
- ➔ më tepër cilësi
- ➔ më shumë kopje
- ➔ botime speciale “Qyteti mbështet të rinjtë”, “Qyteti për fëmijët”, “Pro Biznes”
- ➔ përmbledhje në anglisht



Qyteti im në duart tuaja

- ➔ A e dini se “Qyteti im” mund ta gjeni në pikat e tregëtimit të shtypit?
Tek njësia përballë shitjes së ujit
Tek Pazari
Bul. “Republika”, Libraria në krah të Bankës Greke
Libraria tek ish Vetëshërbimi
- ➔ A e dini se “Qyteti im” mund ta keni në e-mail-in tuaj?
Na shkruani e-mail-in tuaj në adresën tonë: qyteti.im@bashkiakorçe.gov.al
- ➔ A e dini se “Qyteti im” mund ta gjeni në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë?
www.bashkiakorçe.gov.al

Të nderuar lexues të revistes “Qyteti im”!
Kudo që ndodheni, brenda apo jashtë qytetit të Korçës, ju falenderoj që gjatë këtij viti keni zgjedhur faqet e revistës “Qyteti im”, për të marrë informacionin e nevojshëm rreth gjithçkaje që lidhet me qytetin tonë të dashur.

Edhe pse një vit kalon shpejt, në një vit mund të bëhet shumë.

Nuk themi se gjatë vitit 2008 kemi bërë më të mirën për qytetin tone, por me bindje e themi se jemi përpjekur seriozisht që të bëjmë hapa të sigurt përpara, në rrugën tashmë të pakthyeshme të zhvillimit progresiv të Korçës.

Gjatë këtij viti, ka vazhduar me intesitet puna për shtrimin e rrjetit të kanalizimeve në shumë pjesë të qytetit, duke sjellë probleme në infrastrukturën rrugore, por kjo është një kosto e pashmangshme, për ta kthyer shumë shpejt Korçën, në qytetin me infrastrukturën më model në Shqipëri. Për të realizuar këtë objektiv ambicioz, por jo të paarritshëm, gjatë këtij viti, ne kemi projektuar shumë ide të Korçës nesër dhe jemi përpjekur për gjetjen e rrugëve dhe mundësive konkrete të realizimit të tyre.

Në rrugëtimin tonë përgjatë vitit 2008, ne kemi qënë të orjentuar nga vizione të qarta, stratagji zhvillimi dhe programe specifike, realizimi me sukses i të cilave do të bëjë të mundur që Korça, të ecë para shumë shpejt duke rifituar kohën e humbur dhe duke u bërë qyteti ku të gjithë do të duam të jetojmë.

Qyteti ynë po bëhet gjithnjë e më tepër i dashur, jo vetëm për ne, por edhe për shumë vizitorë vendas e të huaj, të cilët zgjedhin pikërisht Korçën për të kaluar fundjavat apo pushimet e tyre. Veç bukurive të shumta natyrore, ata tani gjejnë këtu festa tradicionale, panairë dhe aktivitete të shumta kulturore në të gjithë muajt e vitit. Duke stimuluar zhvillimin e turizmit, ne jemi përpjekur t'i japim kështu një hov zhvillimit ekonomik të qytetit, gjë që do të vazhdojmë ta bëjmë me shumë përkushtim e dashuri edhe në të ardhmen. Këtë vit, qytetarët e Korçës nuk kanë qënë vetëm përfituesit, por edhe partnerët tanë në gjithçka që ne kemi ideuar dhe realizuar në të mirë të zhvillimit perspektiv të qytetit.

Pjesëmarrja aktive e tyre në debate, forume , sondazhe dhe forma të tjera ka dëshmuar një shkallë të lartë qytetarie.

Korçarët e duan qytetin e tyre më të mirë, më të zhvilluar. Bashkia e Korçës, edhe në vazhdim do të bëjë më të mirën, që kjo të kthehet në një realitet të prekshëm për të gjithë.

Ju faleminderit!

Sinqerisht

Niko Peleshi

Kryetar i Bashkisë Korçë



INVESTIME 2008 Korça - sot kan me infrastruktur



Së
bashku
gjate 2008
arritëm

ishte

Gjatë vitit 2008, për qytetin u investuan

15 milion Euro
për fazën e dytë të kanalizimeve

është



tier ndërtimi, nesër qyteti ën më të kompletuar

**Te tjera investime në: Shkolla,
qendra shëndetësore, kënde sportive,
rikonstruksione ambientesh etj**



Rikonstruksion e shtesë, Shkolla
9-vjecare "S.Qiriazi" (e shtrirë në dy vite)

50,1 milion Lek. Në vazhdim



Ndërtim i Shkollës së Re, pranë Shkollës
"D. Progni"
(e shtrirë në dy vite)

73.9 milion Lek. E përfunduar



Sistemim dhe asfaltim tek Blloku i
Banesave kolektive, Lagjia 13
(e shtrirë në dy vite)

14 milion Lek. E përfunduar



INVESTIME 2008



Kanalizimet dhe impianti i ujrave të përdorura (Faza 2) në Lagjet 6,8,11,12, 15,16,17 (periudha: tetor 2008-tetor 2010)

16 milion euro Në vazhdim



Riparim trotuare në Pazari

2.4 milion Lek. E përfunduar



Sistemim-asfaltim Rruga: "10 Korriku"

13 milion Lek. E përfunduar

Sistemim –asfaltim Rruga: “Kongresi i Përmetit” (e shtrirë në dy vjet)

20 milion Lek. Në vazhdim




Shtrimi i fushës së Stadiumit “SKËNDERBEU”

6 milion Lek. E përfunduar



Rikonstruktion i Qendrës Shëndetësore, Rajoni 2

2 milion Lek. E përfunduar



Rikonstruktion i ambienteve të Bashkisë: Zyra e Informacionit; Drejtoria e të Ardhurave; Ambiente Sanitare

2.5 milion Lek. E përfunduar



Fushë e re tenisi

1.5 milion Lek. E përfunduar



Rikonstruktion i Gjendjes Civile në Bashki

2.1 milion Lek. E përfunduar



Qyteti i sërë

Gjatë 2008-ës projekt



Vizioni ynë për Korçën NESËR, veç të tjerash, është një dimension i ri në zhvillimin urban të qytetit. Korça nesër do të ketë më tepër hapësira për këmbësorët, do të ketë investime bashkëkohore të përmasave të mëdha, të cilat do t'i jap një hov zhvillimit ekonomik të qytetit.

Zona Këmbësore

...deri tani

Forumi Urban

2 projektide për Zonën Këmbësore

Ekspozimi dhe marrja e mendimit qytetar

Për herë të parë në Shqipëri, "Design Charette"-konsultim me specialistët

... në vazhdim

Zona Këmbësore, pjesë e Konkursit Ndërkombëtar për Studimin Urbanistik të Qendrës së Qytetit



ardhmes

tuam idetë e Korçës NESËR

Sheshi "Mandolina"

Sheshi "Mandolina", është projekti më i ri i synuar nga Bashkia e qytetit që mendohet se do t'i japë një frymëmarrje të re sheshit para Teatrit "Çajupi".

Me këtë projekt, qytetit do t'i kthehet një nga simbolet që ka lidhje të ngushtë me serenatën korçare.



Kompleksi sportiv "SPORT PLANET"

Një projekt gjigand, për të realizuar në Korçë qendrën sportive më të madhe në Shqipëri. Gjatë 2008-ës u realizuan :

- ➔ Projekti urbanistik
- ➔ Studimi i fizibilitetit
- ➔ Prezantimi i projektit në Expo Real, panairi më i madh i pasurive të paluajtshme





Shtohen sipërfaqet

Gjatë 2008-ës Bashkia Korçë ndërmori iniciativën e një punë e konsiderueshme u bë edhe për rigjerjen

“Një nxënës, një pemë” iniciativa më e re që përfshiu të rinjtë

“Një nxënës, një pemë” ishte iniciativa më e re e Bashkisë Korçë për shtimin e gjelbërimit në qytet me përfshirjen e komunitetit. Në këtë kuadër u sistemuan disa oborre shkollash duke mbjellë pemë, shkurre dekorative e lule si dhe u sistemuan rrugicat midis lulishteve.

Vetëm gjatë 2008-ës, në qytet, janë mbjellë:

- ➔ 1440 drurë
- ➔ 495 shkurre

Lulishte të reja tek

“Shën Mëria” U mbollën:

- 2100 m2 sipërfaqe bar
- 89 drurë
- 147 shkurre dekorative



Kthehet në identitet lulishtja në krah të stadiumit të qytetit

- U shtrua me bar 8000 m2
- U zëvendësuan bordurat e gurit
- U vendosën stola e ndriçim



Ne punojmë “Për një Korçë më të pastër”

Çdo ditë hiqen 74 ton mbeturina urbane pastrohen 456 428 m2 rrugë e trotuare, 32 428 m2 më shumë se viti 2007, si rezultat i shtimit të sipërfaqes së rrugëve e trotuareve të asfaltuara në qytet.

qet e gjelbëruara

a të reja për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra, por
nerimin dhe rehabilitimin e lulishteve ekzistuese




Përfundoi studimi për rehabilitimin e fushës ekzistuese të mbetjeve urbane

Në 2008 –ën përfundoi studimi për rehabilitimin e fushës ekzistuese të mbetjeve urbane me vlerën 20 milion lekë. Landfill-i për depozitimin e mbetjeve të ngurta urbane të Korçës është parashikuar të mundësojë pastrimin e ish-fushës së hapur të mbeurinave të grumbulluara për më tepër se 15 vjet duke realizuar pastrimin final të fushës dhe izolimin përfundimtar të mbetjeve nga mjedisi rrethues.

Vazhdon projekti për ndërtimin e Landfillit të ri të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në Qarkun e Korçës

Vazhdon projekti për ndërtimin e Landfillit të ri të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në Qarkun e Korçës, një investim i KFW me vlerën 20 milion Euro. Në qershor të vitit 2008, u themelua “Kompania e Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në Qarkun e Korçës” sh.a, në të cilën zgjerohet pjesëmarrja nga 22 Bashki e Komuna fillestare në 28 të tilla, të cilat nënshkruan Aktin Themelues dhe Statutin e shoqërisë. Për këtë projekt madhor është kryer studimi i fizibilitetit dhe pritet zbatimi i tij. Menaxhimi i mbetjeve urbane, është një përpjekje e përbashkët e Bashkisë Korçë me komunat e tjera të Qarkut për të krijuar një sistem të ri në menaxhimin e mbetjeve urbane duke kontribuar ndjeshëm në përmirësimin e mjedisit. Kompania do të jetë përgjegjëse jo vetëm për mbledhjen, transportin dhe grumbullimin e mbetjeve, por edhe për pakësimin e sasisë së mbetjeve përmes riciklimit.





Në vitin 2008, 335 milion lekë të ardhura

Së bashku
gjate 2008
arritëm



Në 2008-ën, **59 milion lekë** më tepër se në vitin 2007

Viti 2008	335 milion lekë të ardhura
Viti 2007	275 milion lekë të ardhura

Realizimi i Taksës Vendore mbi Biznesin e Vogël

Në 2008 –ën, **6 milion lekë** më shumë se në vitin 2007

Viti 2008	114 milion lekë
Viti 2007	108 milion lekë

Sfidat e Bashkisë Korçë për vitin 2008 kanë qenë:

- Mbledhja e taksave dhe tarifave vendore ku përfshihen: Tarifat e Pastrimit, Ndriçimit, Gjelbërimit, si dhe Taksa mbi Pasurinë. Për herë të parë, këto taksa u mbledhën nga qytetarët nëpërmjet faturës së ujit, në sajë të marrëveshjes së arritur me Ndërmarrjen e

Ujësjellës-Kanalizime në Korçë.

Si rezultat u dyfishua numri i familjeve të përfshira nga 7 mijë në 2007-ën, 14 mijë në 2008-ën

- Regjistrimi i aktivitetit të të gjitha njësive të Biznesit të Vogël

Si rezultat u regjistruan 365 subjekte të reja.

365 ditë
365 biznese
Çdo ditë, një
biznes i ri

Bashkia stimulon hapjen e bizneseve të reja

Starton projekti “Inkurajimi i sipërmarrësve të rinj”

Me synimin kryesor, zhvillimin ekonomik të qytetit si dhe në kuadrin e një prej programeve më kryesore të Bashkisë “Qyteti mbështet të rinjtë”, Bashkia Korçë inicioi projektin YEP - “Inkurajimi i sipërmarrësve të rinj”. Ky projekt ka për qëllim inkurajimin e iniciativave sipërmarrëse tek të rinjtë, përballjen e tyre me tregun e punës si dhe krijimin e një rrjeti që do të kontribuojë në lehtësimin e punësimit të të rinjve.

Rezultatet e pritshme

- Hapja e 10 bizneseve të reja në qytet
- Punësimi i 20% të pjesëmarrësve në projekt
- Trajnimi i të rinjve në fushën e sipërmarrjes
- Përmirësimi i performancës në përballje me tregun e punës



Incentivat fiskale

Gjatë 2008-ës Bashkia ofroi kushte lehtësuese për bizneset e reja dhe studentët

Tarifë regjistrimi 0 dhe 30% ulje në taksat dhe tarifat vendore për bizneset e reja në kategoritë e mëposhtme:

Bizneset e artizanatit (gurgdhendës, hekurpunues, punime artistike dore etj)

Bizneset që lidhen me teknologjitë e informacionit (ripa- rime kompjuterash, internet kafe etj)

Çerdhe, kopshte, kënde lojrash për fëmijë

Studentët e Universitetit “F. S. Noli” të diplomuar në dy vitet e fundit

Studentët të diplomuar jashtë

Korçës dhe Shqipërisë gjatë pesë viteve të fundit

Së
bashku
gjate 2008
arritëm

2008, viti i aktiviteteve të rëndësishme

Skulptoret ndërkombëtare i dhurojnë Korçës veprat e tyre në gur

KORÇA, qyteti i parë në Shqipëri, që pret skulptorë nga e gjithë bota

Parkut të qytetit të Korçës, i janë shtuar këtë vit 8 skulptura të artit bashkëkohor në gur. Ka qenë Bashkia Korçë, e cila ndërmori për herë të parë në Shqipëri, iniciativën e organizimit të Simpoziumit Skulptura e Parkut “Korça 2008”. Skulptorë nga Gjermania, Japonia, Italia, Sërbia, Rumania e Shqipëria punuan gjatë muajit korrik, për dy javë në Parkun “Rinia” të qytetit. Organizimi i përveçshëm i këtij simpoziumi, synon ta kthejë Parkun “Rinia” të qytetit në një muze të hapur të artit bashkëkohor.



Së bashku
gjate 2008
arritëm

sishme ndërkombëtare në Korçë Kolonia Ndërkombëtare e Pikturës “Ditët e Mios”



Piktorë nga vende të ndryshme të botës, fiksojnë Korçën në telajo

40 piktorë morën pjesë në edicionin e dytë, të Kolonisë “Ditët e Mios”. Në të morën pjesë jo vetëm piktorë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Greqia, por edhe piktorë nga vende të tjera të Europës. Për piktorët, Korça mbetet një studio e madhe, me hapësira për t’u eksploruar, befasuese për pasurinë që mbart, e cila është mjaft frymëzuese për të ushtruar talentin e tyre. Aktiviteti, që do të kthehet në një traditë të përvitshme, synon jo vetëm vendosjen e urave të komunikimit mes artistëve, por sidomos promovimin e vlerave të qytetit.



Konkursi Ndërkombëtar i Fotografisë “Sotir”

Në Korçë fotografë të rinj nga e gjithë bota

Nën siglën e fotografit të madh korçar Kristaq Sotir, në muajin maj u zhvillua në qytetin e Korçës i pari Konkurs Ndërkombëtar për fotografinë. Iniciativës së Qendrës Kulturore “Lindart” iu bashkangjiti edhe Bashkia e Korçës, e cila me këtë aktivitet shënon përpjekjen e dytë për promovimin e kësaj figure pas botimit të Kalendarit 2008, me foto të përzgjedhura të tij. Ky aktivitet nderon njëkohësisht vendlindjen e fotografit të mirënjohur, Korçën e cila gjithmonë ka një hapësirë ku kultura dhe arti promovohen në mënyrë të vazhdueshme.



E meritojmë emrin Arzeta i Kulturës



Koncert Pax Dei



Mbrëmje poetike Liriku
I Dhimbjes së Bukur



Koncert vokal-instrumental nga
Shirli Poleña e Altin Xhema



Koncert i violinistit Nikola Kondakçi



Për mua, Mirjam
dhe Sandri-dramë

Rreth **100 aktivitete** të Qendrës
Kulturore "V. Mio", Teatrit "Andon Z. Çajupi"
dhe Bibliotekës "Thimi Mitko"

Koncerte
Ekspozita
Takime Kombëtare
Takime Ndërkombëtare
Drama
Komedi

Variete
Spektakle
Promovime librash
Mbrëmje poetike
... e shumë të tjera

Së
bashku
gjate 2008
arritëm

Koncert i Kamersolistëve të Augsburgut



Korça, qyteti i festave

Gjithë këto festa... Pse?

“Korça qyteti i festave” nuk është thjesht një slogan, por pjesë e një strategjie vizionare që synon veç gjallërimin të jetës në qytet, promovimin e turizmit, i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të qytetit ”

Duke e vendosur turizmin si prioritet, Bashkia Korçë, këtë vit, hartoi Planin e Veprimit për Zhvillimin e Turizmit, si rrjedhojë direkte e një prej qëllimeve të Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik të qytetit. Ky plan bashkoi idetë e të gjithë aktorëve lokalë me impakt në zhvillimin e turizmit dhe u mbështet nga organizata SNV. Plani i Veprimit të Turizmit mori edhe miratimin e Këshillit Bashkiak në muajin dhjetor.

Shumë festa

- ➔ Më shumë **vizitorë** në qytet
- ➔ Më shume **klientë** dhe të **ardhura** për bizneset lokale
- ➔ Më shumë **gjallëri** dhe **optimizëm** në qytet



Festa e birrës... vetëm në Korçë!



40 000 vetë
qytetarë të Korçës,
dhe të ardhur nga
brenda dhe jashtë
Shqipërisë u bënë
pjesë e festës

Së
bashku
gjate 2008
arritëm

www.festaebirres.com

Edhe këtë vit sezoni turistik kulmoi me Festën e Birrës. Në datat 14-17 gusht, Bashkia e Korçës organizoi për herë të dytë këtë festë, e cila është kthyer në një patentë të qytetit.

**24 orë spektakël në 4
netë të zjarra me solistë
dhe grupe të njohura
muzikore**

Elita 5
Burn
Redon Makashi
Aleksandër Gjoka
Motrat Libohova
Bledar Sejko

Djemtë e Detit
Kamela & Genti
Eli Fara
Anxhela Peristeri
Bojken Lako
... e shume të tjerë



1 0 0 0 0 0 g o t a B i r r a K o r ç a



Për herë të parë Panairi i Poçerisë

Artizanët e punimit të baltës në qendër të qytetit

Në muajin prill, në sheshin para Katedrales "Ringjallja e Krishtit", Bashkia Korçës organizoi Panairin e Poçerisë. Duke synuar rigjallërimin e traditës së vjetër korçare të punimit të baltës, ky panair bashkoi prodhues të ndryshëm që ekspozuan apo tregëtuan produktet e tyre. Ndër të tjera, pjesëmarrëse në këtë panair ishte dhe Prefektura e Follorinës, Greqi. Panairi do të kthehet në një aktivitet të përvitshëm për qytetin.



Karnavalet e Korçës Rikthim në traditë

Karnavalet e Korçës, të gëzueshme dhe të zhurmshme, shumëngjyrëshe dhe mjaft të çuditshme përtej normales së jetës së përditshme, u shpërfaqën para syrit të mijëra qytetarëve që kishin mbushur sheshin para Katedrales, me të gjithë madhështinë e emrit që ato mbartin, duke risjellë kështu nurin e dikurshëm të karnavalit.

30 grupe, prej të cilave 13 nga Korça dhe rrethinat, të tjerë nga Shkodra, Tirana, Kavaja e Berati si dhe grupe nga jashtë vendit, Maqedonia, Mali i Zi dhe Italia, kanë sjellë për mijra qytetarë të pranishëm në këtë festë të madhe, të organizuar në fund të muajit qershor, magjinë e karnavaleve.





Festa e lakrorit

Lakrori me dy petë kthehet në festë

Festa e Lakrorit, një festë e re dhe veçantë për qytetin dhe për të gjithë ata që e shijuan. Amvisat korçare, ato të Polenës si dhe të Dardhës, gatuan me mjeshtëri lakrorin me dy petë . Pjesëmarrja e “Greal” me freskinë e dhallës, i dha akoma më tepër shije festës. E

veçanta , ishte gatimi në moment i lakrorëve si dhe pjekja e tyre në saç. Festa mbledhi në parkun “Rinia”, jo vetëm qytetarë korçarë, apo të rrethinave, por edhe të ardhur nga Tirana, Durrësi etj, kureshtarë për këtë festë të re të qytetit të Korçës.

➔ Java e Muzikës

Ditët që i ndryshuan pulsën qytetit

Për gjashtë ditë në muajin korrik, qytetarët e Korçës u bënë pjesë e aktiviteteve muzikore të cilat gjallëruan jetën në qytet. Kanë qenë këngëtarët më në zë të Maratonës së Muzikës Popullore dhe më pas, të rinjtë e talentuar të “Star Akademi”, të cilët për dy mbasdite, me rritmet e tyre, gjallëruan sheshet në qytet. Në ditët e tjera, kanë qenë baret më të mira në qytet që kanë mirëpritur grupe të njohura të muzikës “live” të cilat ishin zgjedhur për të qenë pjesë e Javës së Muzikës. Java e Muzikës u ofroi qytetarëve një mundësi më shumë për t’u argëtuar në këto ditë vere dhe i shtoi gjallërinë qytetit.



Së bashku
gjate 2008
arritëm



Java e kinemasë

Magjia e ekranit të madh në natyrë

Përgjatë një jave, në sheshet dhe lokalet më të frekuentuara të qytetit të Korçës, u shfaqën filma për fëmijë e të rritur. Magjia e ekranit të madh, erdhi nëpërmjet Kinemasë Verore, ku qytetarë të moshave të ndryshme shijuan në natyrë filmat më të suksesshëm ndër vite të kinemasë botërore dhe asaj shqiptare. Ndjekja e tyre në natyrë u kthye për qytetarët korçarë një moment i paharruar relaksi dhe kënaqësie.





Panairi i Fundvitit

Korça feston edhe në dimër

Me sloganin: “Festojmë edhe në dimër”, Bashkia e qytetit, ftoi për të festuar në Panairin e Fundvitit, të çelur në qendër të qytetit, të gjithë qytetarët korçarë dhe jo vetëm. Atmosferës festive nuk i mungoi asgjë; shtëpitë e drurit, elementët dekorativë, lodrat, ëmbëlsirat, pijet tradicionale, mollët e pjekura, gështenjat, babagyshët me karrocë, muzikë në shesh, shoë e shumë të tjera. Panairi i Fundvitit 2008, është eksperiencë e parë në Shqipëri. Bashkia Korçë, synon kthimin e tij në traditë të përvitshme, duke e bërë Korçën, qendrën e festimeve në Shqipëri.



Së bashku gjate 2008 arritëm

Për të promovuar qytetin si destinacion turistik, Bashkia Korçë publikoi këtë vit:

1 Kalendarin e aktiviteteve (për herë të parë në Shqipëri)

2 Çelsin Turistik të Korçës



Fjalën

e ke ti!

Motoja jonë: Të rritim t dhe të nxitim pjesëmarrjen

Buxhetimi me pjesëmarrje

Qytetarët e Korçës, për të dytin vit radhazi, dhanë mendimin e tyre për Prioritetet e investimeve dhe Buxhetin e Bashkisë Korçë.

Gjatë 8 ditëve në muajt shtator e tetor, të grupuar sipas lagjeve dhe Rajoneve Administrative, ata zhvilluan takime të hapura, në të cilat patën mundësinë të diskutojnë e të propozojnë konkretisht duke konfirmuar edhe angazhimin e tyre në projektet komunitare. Në fund Këshilli Bashkiak do të miratojë këto propozime, të cilat do të investohen nga Bashkia e qytetit gjatë vitit 2009.



Së bashkë gjatë 2 arritë

Transparencën ndaj qytetarëve në vendimmarrje


Sporteli i informimit qytetar

- ➔ Gjatë vitit 2008 sporteli i informimit qytetar mori një fizionomi të re, me qëllim përmirësimin e komunikimit dhe shërbimeve ndaj qytetarit.
- ➔ Punonjësit e informacionit, asistojnë dhe orientojnë qytetarët në plotësimin dhe tërheqjen e kërkesave apo ankesave.
- ➔ Këto kërkesa dhe ankesa, do të përcillen në drejtoritë e tjera, për të siguruar një zgjidhje sa më të shpejtë, brenda afateve ligjore.
- ➔ Në sportelet tona, ju mund të jepni mendimin tuaj në lidhje me prioritetet në investime që duhet të ketë Bashkia.



SONDAZHI, një mënyrë e re e marrjes së mendimit qytetar

Me moton “Më shumë hapësirë për qytetarët”, Bashkia Korçë ftoi qytetarët të bëhen pjesë e vendimmarrjes për projektin e Zonës Këmbësore. Gjatë dy javëve në muajin prill, qytetarët vizituan ekspozitën e hapur me dy variantet e projektit për këtë zonë dhe dhanë mendimin e tyre duke plotësuar sondazhin e përgatitur për këtë qëllim. Sondazhi, si një mënyrë e re e marrjes së mendimit qytetar, do të aplikohet edhe për projekte të tjera të rëndësishme që do të zbatojë Bashkia e qytetit gjatë vitit 2009, të cilat kanë impakt të drejtpërdrejtë në komunitet.



SONDAZHE TË TJERA:

Korça qyteti i festave	në proces
Mbi raportin bashki - biznes	në proces
Mbi infrastrukturën e Lagjes 9	i përfunduar
Mbi rikonstruksionin e pallatit të ish MAPO	në proces
... e shumë të tjerë	

Gjatë 2008-ës punuam

“... për një qytet ku të rinjtë realizojnë aspiratat e tyre për shkollim e punësim, ku të moshuarit jetojnë ditë të bardha, një qytet që ka gjithmonë një dotë të zgjatur, për të nxjerrë nga vështirësia dhe ku problemi yt gjen një zgjidhje”.

Niko Peleshi



Për herë të parë, një qendër për të moshuarit

Bashkia e qytetit, në muajin shtator, hapi të parën “Qendër Komunitare për Moshën e Tretë” në qendër të Korçës.

Për 50 banorët e parë të saj, qendra ofron ambient familjar, leximin e shtypit të ditës, kafën e mëngjesit falas, si dhe shërbim mjekësor e psikologjik gjithashtu falas.

Hapja e kësaj qendre ka gjetur përkrahjen e komunitetit. Si rezultat, gjatë 2009-ës Bashkia ka planifikuar hapjen e 4 qendrave të tjera për moshën e tretë në periferi të qytetit.



Mjete shkollore për fëmijët në nevojë

“Kite shkollore për fëmijët”, ishte projekti me të cilin Bashkia e qytetit të Korçës, me rastin e fillimit të Vitit të Ri Shkollor 2008-2009, iu erdhi në ndihmë fëmijëve jetimë dhe fëmijëve në nevojë.

Përfitues të tij u bënë 80 fëmijë, prej të cilëve 50 fëmijë jetimë (pa prindër ose me një prind) dhe 30 të tjerë fëmijë në nevojë, pra fëmijë që jetojnë në familje me kushte të vështira ekonomike.



Në qytet si gjithë të tjerët

50 fëmijë të shkollave periferike të qytetit, një pjesë e të cilëve vijnë nga komunitetet në nevojë, vizituan për herë të parë institucionet kulturore më të rëndësishme të qytetit.

Me sloganin “Në qytet si gjithë të tjerët”, kjo vizitë ishte dhurata që u bëri Bashkia e qytetit këtyre fëmijëve në Ditën Botërore të të Drejtave të Fëmijëve. Po në këtë ditë, Kryetari Bashkisë Nko Peleshi vizitoi fëmijët e kopshtit rom “Lulet e vogla”. Gjatë vizitës, ai dhuroi për secilin një paketë me mjete mësimore dhe më pas dëgjoji prej tyre, të drejtat që kanë fëmijët për t’u shkolluar, argëtuar etj.

për një qytet më social



Bashkia institucionalizon mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Për herë të parë këtë vit, pranë Bashkisë Korçë filloi të funksionojë Seksioni i Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve, një strukturë e re në përbërje të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale. Bashkia e qytetit, ndër të tjera, nëpërmjet kësaj zyre, po implementon projektin "Një përqasje ndërsektoriale në mbrojtje të fëmijëve". Kjo iniciativë përfshin dhe angazhon të gjitha strukturat dhe aktorë të tjerë lokalë, në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve në nevojë.



Jetimët, më shumë vëmendje

Gjatë 2008-ës, Bashkia Korçë, ka tërhequr vëmendjen e të gjithëve veçanërisht të qeverisë dhe biznesit për më shumë përkujdesje dhe një dorë të ngrohtë për fëmijët jetimë.



Strehimi

Prioritet i strehimit: Ndërtimi i banesave sociale me qera

Gjatë 2008 –ës:

- U strehuan 80 familje, në banesa sociale me kosto të ulët. Nga këto, 30 hyrje i përfituan komuniteti egjiptian dhe ai rom
- Përfituam kredinë prej 1.2 milion euro nga Banka Europiane për Zhvillim, e cila do të shërbejë për ndërtimin e 3 pallateve, me 96 apartamente të tipit: "Banesa sociale me qera".
- Fituam gjysmën e grantit të qeverisë shqiptare, 150 milion lëkë për ndërtimin e banesave me qera, me kosto të ulët, për të pastrehët e komunitetit rom.
- U hartua dhe u miratua projekti për strehimin e 42 familjeve rome në nevojë.
- U hodhën bazat, që në 2009-ën, të fillojë ndërtimi i një pallati me 40 hyrje për të pastrehët, që aktualisht banojnë në banesat e ish pronarëve me mundësi financiare për të përballuar kredinë.

➔ Viti 2003	20 apartamente
➔ Viti 2004	24 apartamente
➔ Viti 2005	40 apartamente
➔ Viti 2007	80 apartamente
➔ Viti 2008	80 apartamente

- Bashkia Korçë është në proces të hartimit të strategjisë 10 vjeçare të strehimit dhe parashikon që në planin afatmesëm 2009-2011 të ndërtojë çdo vit 136 apartamente, nga të cilat 40 me fondet e buxhetit të shtetit dhe 96 apartamente, me financim të kredisë së CEB apo nga burime të tjera.

Për fëmijët, një



Festojmë së bashku 1 Qershorin!

Festa e 1 Qershorit, këtë vit, ka qenë e gjitha për vogëlushët e qytetit. Festa, bashkoi qindra fëmijë të shoqëruar nga prindërit në pjesën qendrore të Parkut "Rinia", ku Bashkia Korçë kishte zbukuruar sheshin me larmi ngjyrash, duke e shndërruar këtë pjesë të qytetit në arenën e lojrave, argëtimit dhe festës. Fëmijët u argëtuan tek këndi i lojrave, këndi i pikturës, këndi "Thuaj një dëshirë" dhe ai i vizatimit të fytyrës, të cilat kanë zbavitur fëmijët për orë të tëra.

Kampe verore për fëmijët

Bashkia e qytetit, përgjatë muajve të verës, organizoi për të dytin vit radhazi, Kampin Veror Ditor, në të cilin morën pjesë 240 fëmijë të moshave nga 6 deri në 12 vjeç. Për herë të parë gjatë këtij viti, Bashkia e Korçës në bashkëpunim me Terre des Hommes, krijoi fondin social për fëmijët, duke mundësuar pjesëmarrjen në të edhe të fëmijëve që vijnë nga familje me probleme social-ekonomike.



Së
bashku
gjate 2008
arritëm

qytet më i mirë

Vogëlushët “cicërojnë” mbi telajo

Edhe këtë vit, ekspozita e fundit e çelur në Qendrën Kulturore “Vangjush Mio” të qytetit ka patur autorësinë e fëmijëve. Nën titullin “Cicërima mbi telajo” fëmijët e talentuar të kopshteve të qytetit ekspozuan punët e tyre më të mira në vizatim, pikturë e aplikacion.



“Artistët e vegjël” të qytetit, në rrugë të mbarë

50 fëmijët korçarë, përgjatë muajve shtator -dhjetor morën pjesë në kurset “Artistët e vegjël” të çelura nga Bashkia Korçë, demonstruan aftësitë e fituara në programin artistik në prag të festës së Vitit të Ri . Ekspozita me punët e nxënësve të kursit të fotografisë, vizatimit dhe poçerisë u pasua dhe nga një koncert i kitaristëve të vegjël dhe nxënësve të kursit të baletit.



Qyteti mbës

Bursa për më të mirët e shkollave të mesme

Bashkia e Korçës u pagoi një bursë mujore, 52 nxënësve më të mirë të 6 shkollave të mesme të përgjithshme dhe ato profesionale në qytetin e Korçës. Kjo u bë e mundur në zbatim të projektit “Bursa për më të mirët”, i cili u zbatua këtë vit për herë të parë nga Bashkia e qytetit.

Veç burses, nxënësve u është siguruar edhe nga një kartë biblioteke, duke përfutur kështu të gjitha shërbimet e bibliotekës së qytetit falas, përfshi edhe internetin.



Panairi i Punës Korça 2008

- ➔ 280 të rinj të intervistuar
- ➔ 50 të rinj të punësuar

Gjatë muajit korrik, Bashkia e Korçës organizoi edicionin e dytë të Panairit të Punës “Korça 2008”. Panairi i Punës është një praktikë e re, ku vijnë përballë kërkesa dhe oferta sipas të gjitha rregullave të tregut. Këtë vit, ky panair erdhi pas një eksperience të suksesshme nga viti i kaluar, në të cilin morën pjesë 15 biznese të cilët intervistuan 280 studentë dhe u punësuan 50 prej tyre. Panairi i krijoi biznesit një mundësi më shumë për të



htet të rinjtë



2008 ...ofrojmë mundësi

reklamuar biznesin e vet dhe studentëve, një kontakt me ofertat për punësim, mundësi konkrete punësimi dhe mundësi për të filluar një karrierë të suksesshme.

40 studentë punësohen gjatë verës pranë Bashkisë

40 studentë të intervistuar e të përzgjedhur në Panairin e punës, filluan punën në sektorë të ndryshëm të administratës bashkiake për një periudhë kohe prej dy muajsh. Këta të rinj, po thellojnë njohuritë e tyre në fusha të ndryshme sipas profilit për të cilin ata po studiojnë Përgjatë dy muajve, këta studentë u bënë pjesë aktive e projekteve të Bashkisë Korçë.

Shkolla Verore e Fotografisë dokumenton vlerat e qytetit

Shkolla Verore e Fotografisë ishte projekti më i ri i Bashkisë Korçë, i cili u krijoi mundësinë të rinjve të apasionuar pas fotografisë, të zgjeronin njohuritë e tyre rreth peisazhit dhe fotografisë së arkitekturës. Një staf i kualifikuar pedagogësh përgatiti profesionalisht këta të rinj, të cilët të orientuar dhe të fokusuar drejt vlerave të trashëgimisë kulturore, peisazhit dhe bizneseve, krijuan një fond të konsiderueshëm fotografish.

Shkolla Verore e Fotografisë, është në vazhdim të traditës së krijuar me aq mjeshtëri nga fotografi i madh "Sotiri" me të cilin jo vetëm Korça, por e gjithë Shqipëria mburret edhe sot.



e-city

Gjithçka p

Programi synon ta kthejë Korçën në qytetin me a

Bashkia dhuron kompjutera për maturantët e shkëlqyer

Bashkia Korçë u dhuroi kompjutera maturantëve më të mirë të vitit shkollor 2007-2008. Kanë qenë 25 maturantë të dalluar të shkollave të mesme të qytetit të cilët përfituan secili nga një kompjuter me një fond nga buxheti i Bashkisë Korçë.



Kurse interneti falas, zgjerojmë hapësirën e komunikimit

Pranë Bibliotekës “Thimi Mitko”, Bashkia Korçë zhvilloi kurse interneti falas për të gjithë të interesuarit veçanërisht për të rinjtë e qytetit. Kjo iniciativë, e cila u financua tërësisht nga Bashkia, ishte pjesë e projektit “Mësojmë internetin” dhe synoi, mësimin e programeve bazë të navigimit në internet dhe përdorimit të postës elektronike. Tashmë, interneti në këtë sallë ofrohet falas, për të gjithë anëtarët e Bibliotekës së qytetit.



Së
bas
gjate 2
arrit

Për herë të parë

aksesin më të madh në teknologjitë e informacionit

Kliko: www.bashkiakorce.gov.al

Çfarë ju ofrojmë:

- Gjithçka për qytetin e Korçës (histori, turizmi, bizneset, institucionet, harta, shërbimet)
- Shërbimet e Bashkisë Korçë
- Programet mbi të cilat Bashkia punon
- Aktivitetet
- Lajmet më të fundit
- Publikimet e Bashkisë Korçë (të gjitha botimet e gazetës zyrtare "Qyteti im")
- Njoftime
- Opinione të qytetarëve
- Mundësi për të na shkruar e për të marrë përgjigje online, në lidhje me një kërkesë apo ankesën tuaj



Terminali në hyrje të Bashkisë,
24 orë informacion në 7 ditë të javës

Tashmë të gjithë qytetarët të cilët kanë nevojë të njihen më mirë qytetin e Korçës, apo ju nevojitet të vjelin më shumë të dhëna rreth punës së Bashkisë Korçë dhe shërbimeve që ajo ofron, mund të përdorin terminalin e vendosur në hyrje të Bashkisë. Nëpërmjet tij qytetarët do të kenë mundësi të aksesojnë faqen e Internetit të Bashkisë si dhe informacione të ndryshme që ndodhen në serverin e saj 24 orë në 7 ditë të javës.

Sport për të gjithë

Për herë të parë, Lojrat Rinore Rajonale “Korça 2008”

Për herë të parë gjatë 2008-ës, u zhvilluan në qytetin tonë, Lojrat Rinore Olimpikë Rajonale “Korça 2008”, në të cilat Bashkia Korçë kishte mbështetjen e Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe të Komitetit Olimpik Shqiptar.

Në të morën pjesë, nxënës të shkollave 9-veçare nga Korça, Erseka, Devolli dhe Pogradeci, të cilët u ndeshën në disa lloje disiplinash: minifutboll, volejball, basketboll e atletikë, sporte që mbajnë peshën kryesore në traditën tonë sportive.



Krosi i Parë Ndërkombëtar, “Korça City Race 2008”

Qyteti i Korçës mirëpriti Krosin e Parë Ndërkombëtar, duke u bërë arena e një aktiviteti të madh sportiv.

Çelja e krosit, në mënyrë simbolike, u bë nga nxënësit e shkollave 9-veçare dhe të mesme nga ku më pas garuan sportistët profesionistë. Protagonistë të garës u bënë atletë profesionistë nga mjaft ekipe shqiptare, si dhe atletë nga shteti fqinj Greqia. “Korça International City Race 2008” u zhvillua në prag të 100 –vjetorit të krijimit të Shoqërisë së parë Sportive “Vllazëria” ngjarje kjo që do të përkujtohet me veprimtari të shumta sportive.

Futboll: Skënderbeu, kryesuesja e Kategorisë së Parë në sezonin dimëror 2008

Objektivi tashmë është arritur. Skuadra e Futbollit “Skënderbeu” e mbylli me sukses sezonin dimëror 2008 duke u renditur e para. Performanca e mirë kësaj skuadre, pas rekrutimit të disa emrave të njohur të futbollit shqiptar, rriti entuziazmin dhe besimin në rradhët e saj. Skuadra tashmë është pretendentja kryesore për Superiore.

Klubi Shumësportësh në Korçë

Basketboll për meshkuj, hyjmë në grupin e më të mirëve A1 Atletikë për femra, mban në tension klubin e Tiranës kampione për nxjerrjen e elementëve cilësorë ndër vite

Dy sportistët më të reja të basketbollit korçar për femra, Ornela Lalaj dhe Eli Papa 14 & 13 vjeç, kanë përfaqësuar koshin Shqiptar në edicione ndërkombëtar në të cilat vendi ynë është përfaqësuar denjësisht

Ekipi i gjimnastikës, kampionia në fuqi për të 6 vite me radhë

Programet e Bashkisë 2008



...një punë e mirëorientuar

Realizimet e vitit 2008: Një premtim i mbajtur

Gjatë vitit 2008, punuam duke u bazuar në 7 programet e Bashkisë dhe realizuam projekte të shumta në kuadër të zhvillimit ekonomik, zhvillimit të turizmit, mbështetjes së të rinjve dhe fëmijëve, zbatimit të politikave sociale për kategoritë në nevojë, përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje etj.

Premtuam

Informatizimi i Bibliotekës "Th.Mitko"
Rrugë dhe sipërfaqe të gjelbra
Grande për biznese te reja
Incentiva fiskale për biznesin
Simpoziumi Ndërkombëtar i Skulptorëve
Konkursi Ndërkombëtar i Fotografisë "Sotir"
Kolonja Ndërkombëtare e Piktorëve
Karnavalet e Korçës
Festa e Birrës
Panairi i Poçerisë
Muzeu i ri i Artit Mesjetar
Zona këmbësore
Karta 16 – 24

Realizuum

Në proces
Në proces
Në proces

Të tjera projekte gjatë 2009-ës:

Rikonstruksioni i Bul. "Republika", i shoqëruar me ndriçim, restaurim fasadash e rrethim me kangjella decorative
Rikonstruksioni i Bul. "Gjergj Kastrioti", rigjenerim e sistemim i sipërfaqeve të gjelbra dhe unifikim i fasadave
Vendosja e emërimit të banesave, rrugëve e shesheve
Projekti i zbatimit dhe vendosjes së tabelave treguese në Unazën e Vogël të qytetit
Konkursi Ndërkombëtar për Studimin Urbanistik të qendrës së qytetit
Sistemim, asfaltim dhe lulishte në Lagjet 6, 7 dhe 18
Kënde lojrash në bllokun e banesave kolektive, Lagjia 13
Fundjava e Muzikës Live
Ditët e Filmit Ndërkombëtar
Qendra rinore
100 vjet klubi sportiv "Skënderbej"
Guida e investimeve
Fondi i Shoqërisë Civile (CSDC)
Zyra e Informacionit Turistik
Korça në City Lighs
Hot Spots
Më shumë incentiva fiskale për biznesin
Teatri shëtitës i kopshteve
Kantinat shkollore
Edukimi përmes riciklimit





Falenderojmë ata që kanë mbështetur Bashkinë Korçë gjatë 2008-ës

AMC	DSHP	Korcajone.net	Senati Rinor
ARZH	Emporiki Bank	Korsel	Simaku
Banka Credins	Euromax	Kryqi i Kuq	SNV
Banka Popullore	Favina	LA Travel	Teknondërtim
Beton Plus	Fondacioni Kenedi	Marketing	Terre des
Birra Gösser	Foto Xhimi	Distribution	Top Channel
Birra Korça	Grand Hotel	Pastiçeri Dajana	Hommes
Birra Skopsko	Greal	PCV	UNICEF
BKT	GTZ	Pro Credit Bank	Union Bank
CAAP	Gulliver OK	QTU	USAID
CSDC	Hotel Koçibelli	Raiffeisen Bank	Videoteka Erlada
DHTI	Kapurani VIARA	Red Bull	Western Union
Drejtoria Arsimore	Konstruksion '93	Sallameri FIX	
Rajonale	Konsullata Greke	Sallameri TONA	

Shënim: Mbështetësit janë listuar sipas rendit alfabetik

Përgatitën:

Ana Qeramixhi
Benila Tërova
Sofjola Kotelli
Mikel Llogori

Ndihmuan:

Stafi i Bashkisë Korçë
Pallati i Kulturës "V.Mio"
Ndërmarrja e Shërbimeve
Publike
Teatri "A.Z.Çajupi"
Klubi Shumësportësh

Fotot nga:

Ana Qeramixhi
Donald Braholli
Vaskë Niço
Orieta Glozheni

Design:

R&T Advertising

Për një qytet ku bashkëjeton tradita me modernen, ku të rinjtë realizojnë aspiratat e tyre për shkollim dhe punësim, ku të moshuarit jetojnë ditë të bardha, një qytet që ka gjithmonë një dorë të zgjatur për të nxjerrë nga vështirësia dhe ku problemi yt gjen një zgjidhje.

Pas një kthese ecim me vrull në një drejtim të ri për të kapur kohën e humbur dhe për të dalë në krye siç i ka hije Korçës. Ky është identiteti ynë i ri.

Mbështesni "Qyteti Im"



Për më tepër informacion:

Tel: 082 245755

e-mail: qyteti.im@bashkiakorçe.gov.al

bashkiko@albmail.com

www.bashkiakorçe.gov.al